



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.181/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit” me seli në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Irfan Zushi, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1134/19, të datës 06.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1134/19, i datës 06.10.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, në pikën paragrafin e parë të dispozitivit është vendosur: Aprovohet kërkesëpadia e paditësit” me seli në Mitrovicë, si e bazuar. Në paragrafin e dytë anulohet aktvendimi nr.... i datës 03.04.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit DUD-it të datës 16.03.2019 të lëshuar nga Zyra Doganore Mitrovicë. Në paragrafin e tretë Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit” me seli në Mitrovicë, t’ia kthej shumën prej 3,776.26€ (tremijë e shtatëqind e shtatdhjetë e gjashtë euro e njëzet e gjashtë cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore të datës 16.03.2019, të Zyrës Doganore në Mitrovicë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës Dogana e Kosovës, me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtin për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa, të prishet aktgjykimi A.nr.1134/19, të datës 06.10.2020, si të pa bazuar me ligj, të refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar me ligj dhe të lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t’ia kthej Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në rivendosje.

Gjykata Komerçiale- Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin e kundërshtuar nr. i datës 03.04.2019, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit DUD-it të datës 16.03.2019, të lëshuar nga Zyra Doganore në Mitrovicë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se pas administrimit të provave të kësaj çështje administrative doganore ka konstatuar se dokumentacioni i prezantuar nga paditësi është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganim të mallit lëndor në pajtim me nenin 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave.

Si rezultat i kësaj paditësit i është ngritur baza doganore dhe është detyruar që të paguaj taksa doganore (Doganë, Akcizë dhe TVSH) në vlerë më të lartë, se të deklaruar me faturën e mallit të importuar për shumën e përgjithshme prej 3,776.26€.

Nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata erdh në përfundim se pretendimet e paditëses janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, konform nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. Prandaj, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit të nenit 292 pika b të KDAK-së nr., nenit 46 par.2,4 5 të LKA-së, e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e anuluar vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurin që paditësit t'ia kthej shumën prej 3,776.26euro, të paguar më tepër për shkak të rivlerësimit të padrejtë të mallit, në emër të detyrimeve importuese, për mallin e zhdoganuar përmes të DUD-it të datës 16.03.2019, të lëshuar nga Zyra Doganore në Mitrovicë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të

aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë që është e bazuar në ligj mbi bazën e të cilave e paditura e ka ngarkuar paditësin me pagesë shtesë në emër të taksave doganore importuese.

Në këtë rast provat , të dhënat e disponueshme të prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative-komerciale. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se paditësja në procedurën administrative-komerciale tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ ka paraqitur dokumentacionin valid dhe të mjaftueshëm si provë për DUD-it të datës 16.03.2019, librezën e regjistrimit të automjetit, pagesën bankare ndërkombëtare të datës 07.03.2019, faturën me nr. të datës 12.03.2019 dhe deklaratën e tranzitit të datës 15.03.2019 me të cilat dokumentacione është paguar vlera e mallit të kontraktuar dhe të gjitha këto dokumentacione rezultojnë të jenë të harmonizuara sai përket vlerës së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109.

Në raport me pretendimet e të paditurës se çmimi është marr nga interneti, çmim i cili është përcaktuar në bazë të vitit dhe llojit të automjetit dhe në bazë të karakteristikave të tjera të cilat janë të detajuara e sipas të cilave është caktuar vlera e mallit nga i cili është zbritur përqindja e amortizimit të automjetit. Këtë pretendim Kolegji i Gjykatës Komerciale e refuzoj si të pa bazuar për faktin se asnjë dispozitë e legjislacionit doganor nuk parasheh se vlera e deklaruar e mallit duhet të jetë në përputhje me vlerën e deklaruar nga katalogu-interneti. Po ashtu pretendimi i të paditurës se mungon kontrata e shitblerjes e lidhur mes importuesit dhe eksportuesit nuk qëndron pasi dispozitat ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave, nuk parashihet detyrimi që deklaratës doganore duhet ti bashkangjitet ky dokument për të vendosur mallin në qarkullim të lirë. Andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke u bazuar në interpretimin e drejtë të dispozitave ligjore sa i përket dokumenteve që duhet ti bashkangjiten deklaratës doganore gjatë zhdoganimit të mallit, dhe nga kjo rezulton se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar duke përkrahur edhe numrin e faturës për pagesën e mallit lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj,

ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.181/22, me datë 06.10.2022

Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti